

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE
“Bar Lulishtja” Sh.p.k**

Më datë 28/09/2020, në qytetin e Tiranës është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“Bar Lulishtja” Sh.p.k.**

Themelues të shoqërisë janë ortakët:

Z. Aldo Elezi, i datëlindjes 20/08/1987, lindur në Kavajë, banues në adresën: Rruga: Zonja Curre, Njesia Bashkiake nr 2, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I70820104Q

Z. Rinold Ibra, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30/05/1996, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga:Ali Demi, Pallati 265,shkalla 1, apartamenti 3, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : J60530046D

**NENI 1
KUADRI LIGJOR**

Shoqëria **“Bar Lulishtja” Sh.p.k.** është person juridik shqiptar dhe funksion në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**NENI 2
EMERTIMI**

Emërtimi i shoqërisë është **“Bar Lulishtja” Sh.p.k.** Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k .

**NENI 3
SELIA E SHOQERISE**

1. Shoqëria e ka selinë në qytetin e Tiranës, në adresën: Rruga: Sitki Cico, Pallati 133, apartamenti 3 , Njesia Bashkiake Nr. 3, Tiranë.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të ortakëve të saj .

NENI 4
KOHEZGJATJA

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është për një afat të pacaktuar.
2. Në përputhje me parashikimet e statutit, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj, ose mund ta zgjasë kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 5
QELLIMI DHE OBJEKTI

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “**Bar Lulishtja**” Sh.p.k. do të jenë aktivitete të lidhura kryesisht me: Bar-Kafe, Zgare, Mezeri. Shoqëria mund të kryej edhe cdo lloj aktiviteti tjetër ndihmës dhe të nevojshëm që ka lidhje të mjaftueshme me këtë objekt aktiviteti dhe që nuk bie ndesh me ligjet shqiptare në fuqi.

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar është fiksuar në 10,000 lekë. (dhjete mijë lekë). Ai mund të rritet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.
2. Kapitali ndahet në 2 kuotë me vlerë totale 10,000 lekë. (dhjete mijë lekë).

NENI 7
KUOTAT

Kuotat e pjesëmarrjes janë:

1 kuotë me vlerën 50 % (njëqind përqind) të kapitalit është në zotërim të **Z. Aldo Elezi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20/08/1987, lindur në Kavajë, banues në adresën: Rruga: Zonja Curre, Njesia Bashkiake nr 2, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi I70820104Q

1 kuotë me vlerën 50 % (njëqind përqind) të kapitalit është në zotërim të **Z. Rinold Ibra**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30/05/1996, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga:Ali Demi, Pallati 265,shkalla 1, apartamenti 3, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : J60530046D

NENI 8
ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme :

Asambleja e përgjithshme krijohet nga ortakët themelues:

Z. Aldo Elezi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20/08/1987, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Zonja Curre, Njesia Bashkiake nr.2, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I70820104Q

Z. Rinold Ibra, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30/05/1996, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga:Ali Demi,Pallati 265,shkalla 1, apartamenti 3, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : J60530046D

2. Administratori :

Administratori i shoqërisë zgjidhet për një afat 5 (pesë) vjecar, me të drejtë ripërtëritje **Z. Aldo Elezi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20/08/1987, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Zonja Curre, Njesia Bashkiake nr.2, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr identifikimi : I70820104Q

NENI 9

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Shoqëria do të organizohet dhe do të funksionojë në bazë të parashikimeve të përcaktuara në statut.

NENI 10

LIGJI I APLIKUESHEM

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe cdo bazë ligjore të parashikuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 11

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Palët e interesuara kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kompetente për cdo kundërshtim që kanë rreth aktivitetit të shoqërisë.

NENI 12

DISPOZITA KALIMTARE

Ky akt themelimi hyn në fuqi nga data e miratimit dhe regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Akt themelimi u përpilua në dy kopje në gjuhën shqipe .

ORTAKET THEMELUES

Emer Mbiemer

Rinold Ibra



ALDO ELEZI

